

Çamërioti i fatit tragjik - Bilal Xhaferri (1935 -1986)

Kosova, më shumë se nga historianët, ishte dhimbje dhe krenari e krijuesve letrarë. Kosova e këtyre krijimeve letrare është tërësia e tokës shqiptare, e mbetur jashtë kufijve politik të shtetit shqiptar, duke u mbështetur në faktografinë historike të këtij trualli.


Më 1943 janë botuar dy vepra të plota për Kosovën, historinë dhe madhësitinë e saj, ajo e Hamit Kokalarit "Kosova, djep i shqiptarizmit" dhe e dr. Vasfi Samim Visokës "Nëna Kosovë", cilësuar si Shqipëri e vërtetë. Titujt e veprave që cituam, poezitë e poemat e krijuesve të tjerë dëshmojnë për krenarinë e të gjithëve me Kosovën e kosovarin, me dashurinë e respektin që kishin këta për këto troje, të robëruara gjatë.

● Me t'u shfaqur në letrat shqipe ky autor, zgjoi interesimin krijuesve dhe hetuesve. Të parët e lakmuuan, kurse të dytët e injoruan dhe e larguan. Kështu ishte fati i të riut Bilal, i cili për një kohë të shkurtër bëri emër në letërsinë shqiptare. Ai veprroi sa mundi në vendlindje, por kur mendimit iu zu fryma, atij i mbetën dy rrugë të mundshme: të vetëvritet ose të ikë në pakthim. E bëri të dytën. Shkoi në Çikago, ku e përmbylli jetën tragjikisht, në kohën e një jete intensive krijuese. Shkroi, pra, roman, vëllime me tregime e vëllime me poezi.

Veç të tjerash, qofshin ato tematike apo artistike, ai diti ku është e si është Kosova. Poezia "Kosova" është e shkruar me frymëzim të thellë, me një shprehje moderne tepër domethënëse e përmbledhëse. Derisa ndonjë bashkëkohaniku të vet të mëparshëm i duheshin qindra vargje për ta thënë atë që e mundonte apo dëshironte, Bilal Xhaferri e arrin këtë me shprehjen e tij koncize, të zgjedhur dhe domethënëse. Edhe këtu përmendet shtrirja gjeografike e etnikumit, edhe këtu nënkuptohet kreshnikimi shekullor, edhe këtu del nënkuptueshëm plaga e përditshmërisë së fatit të shqiptarit. Edhe sikur të citohet një fragment nga kjo poezi, nuk e ka kuptimin se është shumë e ngjeshur organikisht dhe vetëm tërësia e justifikon dhe përkufizon të tërën dhe shumëdimensionalitetin e kuptimit dhe vlerës së saj. Me gjithëatë kërkohet mendimi ilustrues. Ja.

Kosova

*me ndarje dhe nëndarje gjeografike
me ndarje dhe nëndarje etnike,
që nga ujërat e kulluara të Ohrit,
gjer në errësirën e minierave të Mitrovicës,*



Bilal Xhaferri

*që nga kaltërsitë e brigjeve të Ulqinit,
gjer në themelet e gjakut, në Qelekullën e Nishit.*

Poetin e rrëmben madhështia dhe pasuria e kësaj ane, e përvetësojnë legjendat madhështore dhe pikëtimet e historisë gjithkombëtare dhe së fundi i zymtëson aktualiteti kosovar, vrazhdësia e atij realiteti, por përmbyllja është mbështetur në një optimizëm rezistues.

Kosova

gjithnjë, ashtu si gjithnjë...

me dhëmbë shtrënguar e me shpirt në dhëmbë.

*Kosova, u shqiptarët flasin një gjuhë,
dhe dëgjojnë dy gjuhë,*

së bashku me gjuhën e nënës edhe gjuhën e UDB-së

Kosova

gjithnjë - ashtu.

Me ngarkesë për pjesën e trupit të vet të shpenkuar Çamërinë, Xhaferri shtrin sytë

edhe te pjesët e tjera. Kërkon të gjejë ngjashmërinë apo synon ta marrë forcën, ku të dihet. Ajo që bëhet me zë është tejet pozitive se aktualizimi dhe aktualiteti për çështjen është, ekziston deri në sot, që krijon një kontinuitet zinxhiror dhe pothuajse të njëjtë, varësisht nga aftësitë dhe mundësitë shprehëse që kanë lëvizje. Është interesant dhe e bindshme: po ai fat qahet, po ajo gjeografi shtrirjeje nuk harrohet, po ai emocion mbahet dhe po ajo gjendje pasqyrohet, që si përmbyllje mund të thuhet se po ajo qëndrueshmëri dhe optimizëm për të ardhmen e fitores përmendet e ruhet. Ky sikur është mesazh që ecën brezave për të mos u zhdukur derisa të realizohet, derisa të konkretizohet përjetësisht.

Derisa është kohëzgjatja kaq e madhe dhe kohëruajtja kaq e pazbeur, ec e mos beso se kjo është një pandalshmëri dhe besueshmëri të patjetër me një afërsi historike reale. Edhe pse për Kosovën apo për një pjesë të saj kanë krijuar mjaftpoetë shqiptarë, menduam se kështu do kishte një efekt si vepruam ne të riaktualizohen disa krijime, që ishin të ndaluara, si dhe krijuesit e tyre, por edhe të dëshmohet një e dhënë se Kosova nuk ishte e harruar, pavarësisht nga tendencat e natyrave të tilla, materiale, morale e inkuizicionale dhe erdhëm deri në këto ditë kur memecëllëku na u ka hequr dhe po e themi mendimin bindshëm, arsyeshëm dhe ashtu siç e kërkon vendi e koha, po për të njëjtin qëllim, njëherë çlirimin e Kosovës e më vonë, s'i dihet.

Koha punon gjithmonë për ata që nuk e harrojnë të kaluarën dhe veprjnë pa ndërprerë për të ardhmen. •

Sinan GASHI